




Pranim / Dorozua / Priljena/Predato Received/Delivered	29. 09	2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	2084/2021		115	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.247/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtarë, si dhe Hysni Mustafa-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2232/19 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.346/2019 të datës 20.06.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr. Haki Pavataj, Nr.15 A, në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit më Nr.14-117/01-0099516 të datës 16.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.04.2021, mori këtë

### V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.346/2021 të datës 20.06.2019, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr.14-117/01-0099516/19, i dates 16.05.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës.

### A r s y e t i m

Ndaj Ankuesit, i punësuar në Komunën e Prishtinës sipas Aktit të Emërimit Nr.01 nr.112-594 të datës 01.02.2017, në pozitën "Zyrtar i Lartë i Ndërtimtarisë", me datë 20.09.2018 Kryetari i Komunës së Prishtinës nxjerr vendim me numër Nr.14-116/01-0229773/18, me të cilin nëpunësin civil e pezullon me pagesë nga marrëdhënia e punës.

Në bazë të Aktgjykimit me numër PKR.nr.273/18 të datës 15.11.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, Divizioni Penal, ankuesi është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve për kryerjen e veprës penale "marrje e ryshfetit"i cili dënim zëvendësohet me dënim unik me gjobe në shumën prej 8.600 euro.



Ankuesi, pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit me numër PKR.nr.273/18 të datës 15.11.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, me datë 05.02.2019 parashtron kërkesë tek Kryetari i Komunës së Prishtinës për kthim në vendin e punës, kërkesë në të cilën nga provat e lëndës nuk ka pranuar përgjigje.

Komuna e Prishtinës me datë 12.03.2019 është njoftuar në lidhje me plotfuqishmërinë e Aktgjykimit KR.nr.273/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, andaj Kryetari i Komunës së Prishtinës me datë 15.03.2019 ka parashtruar raport-kërkesë për inicim te procedurës disiplinore për shkeljen e rëndë të supozuar të ankuesit

Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës me datën 02.04.2019, ka nxjerrë vendim me Nr.14-118/02-76646/19, me të cilin vendim ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil".

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor, me datë 02.05.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 14-117/01-0099516/19 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Komunës së Prishtinës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës, me datë 16.05.2019 ka nxjerrë Vendim me Nr. Nr.14-117/01-0099516/19 me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr. Nr.14-117/01-0099516/19 të datës 16.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prishtinës, te cilin e ka pranuar me date 23.05.2019, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 20.06.2019 parashtron ankesën me numër protokoll 2788/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 22.07.2019 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit, e ka proceduar tek Komuna e Prishtinës, ndërsa me datë 30.07.2019, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Prishtinës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës (faqe 1-18).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 06.09.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 01.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim



A.nr.2232/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 06.09.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 19.06.2019.

**Administrimi i provave:** Kolegji për marrjen e vendimit merititor administroj këto prova: Ankesën me numër protokolli 2788/2019 të datës 20.06.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 20.09.2018 për pezullimin e ankuesit; Kërkesa e datës 05.2.2019 për kthimin në vendin e punës; Ankesën e datës 26.02.2019 nga ankuesi për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ndaj vendimit për pezullimin me pagesë; Vendimi i datës 02.04.2019 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës; Ankesën e datës 02.05.2019 nga ankuesi për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; Vendimi i datës 16.05.2019 i KZAK-së i Komunës së Prishtinës; Akt emërimi i ankuesit i datës 01.02.2017; Aktgjykimi PKR.nr.273/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda i datës 09.01.2019; Kërkesa për përgjigje e datës 22.07.2019; Përgjigja në kërkesë e datës 30.07.2019; Propozimi për shqiptimin e masës disiplinore i datës 19.09.2018; Njoftimin e datës 06.09.2019 për ankuesin; Aktgjykimin A.nr.2232/19 i datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se masa disiplinore për shkak të shkeljes së rënd të detyrave të punës duke aplikuar dispozitat e nenit 67, paragrafi 1, nënparagrafin 1.2 pika 1.2.1 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil dhe se vendimi i tillë ka qenë në kundërshtim me dispozitat e nenit 68, dhe se ankuesi pretendon se vendimi pezullues i Komunës së Prishtinës është dashur të zëvendësohet me vendimin parandalues bazuar me dispozitat e nenit 69 të Ligjit për Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me këtë pretendim të ankuesit nga shqyrtimi i të gjitha provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi me datë 26.02.2019 ka parashtruar ankesë nr. 14-117/01-0045101/19 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës kundër vendimit për pezullimin me pagesë dhe se nga provat e lëndës nuk ka marr vendim dhe se ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Këshill kundër heshtjes administrative të organit të shkallës së parë ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht ankuesi lidhur me çështje e ka humbur afatin e ankimimit dhe se Këshilli nuk e ka shqyrtuar pretendimin e lartcekur.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi shqyrtoi pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se pasi që dënimi i shqiptuar me Aktgjykimi PKR.nr.273/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda i datës 15.11.2018 nga dënimi prej gjashtë (6) muaj burgim i është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumën prej 8.600 euro, organi i punësimit e



është dashur ta marrë për bazë neni 90 paragrafi 2 nën paragrafin 2.4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe ankuesit mos ti ndërpresë marrëdhënien e punës .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit nuk është dashur ti ndërprehet marrëdhënia e punës pasi që dënimi prej gjashtë (6) muaj burgim i është zëvendësuar në dënim unik me gjobë në shumën prej 8.600 euro, sipas Aktgjykimi PKR.nr.273/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda të datës 15.11.2018, ka konstatuar që pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm sepse Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, Divizioni Penal sipas Aktgjykimit PKR.nr.273/18 të datës 15.11.2018, ka vërtetuar se ankuesi ka kryer veprën penale "marrje e ryshfetit", dhe e ka dënuar me dënim prej gjashtë (6) muaj burgim i cili dënim i është zëvendësuar në dënim unik me gjobë në shumën prej 8.600 euro, andaj mbi këtë bazë paraqitja e rastit në Komisionin Disiplinor nga Komuna e Prishtinës është bërë në përputhje me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës respektivisht me nenin 63 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.14-118/02-76646/19, të datës 02.04.2019 me të cilin vendim i ka shqiptuar masën disiplinore „Ndërprerje e marrëdhënies së punës” në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht ka Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor ka vepruar në pajtim me të gjeturat e Aktgjykimit PKR.nr.273/18 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda të datës 15.11.2018, pasi që është vërtetuar se ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të punës, andaj në këtë kuptim Komisioni Disiplinor ka vepruar në pajtim me nenin 63 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Nëse nëpunësi civil shpallet fajtor dhe dënohet për kryerje të veprës penale, autoritetet kompetente administrative detyrohen që nga ato elemente të vendimit të gjykatës kompetente, që përbëjnë shkelje të parimeve dhe të rregullave administrative, duhet të urdhërojnë shkarkimin e nëpunësit civil”, në pajtim me nenin 66 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil” dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se nuk është marrë për bazë neni 90 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka konstatuar që nëse i referohemi këtij neni nënkuptohet që në rast se një nëpunës civil dënohet me burg efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër atëherë me një vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ i përfundon marrëdhënia e punës në shërbimin civil ndërsa nëse nëpunësi civil dënohet me më pak se gjashtë (6) muaj rasti i paraqitet Komisionit Disiplinor dhe në bazë të kompetencave të tij Komisioni Disiplinor vendos në pajtim me legjislacionin për shërbimin civil, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar dhe se Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.14-117/01-0099516/19



i datës 16.05.2019, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Civil, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe bazuar në Aktgjykimin A.nr.2232/19 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.247/2021**

**Hysni MUSTAFA**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështjeje Administrative
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

